

SHOQERIA TREGTARE
Me pergjegjesi të kufizuar

"EMPIRE TWO ON ONE" shpk.
TIRANE

AKT THEMELIMI

Ne TIRANE, sot me daten 07/01/2022 ne te nenshkruarit :

1-Viorel Neziri, datelindja 22/05/1984, lindur ne Peshkopi dhe banues ne Durres, madhor ,me zotesi te plote per te vepruar,identifikuar me nr ID I40522020F
2-Brixhilda Vokrri, datelindja 26/07/1997, lindur ne Rreshen dhe banues ne Tirane, madhor ,me zotesi te plote per te vepruar ,identifikuar me nr ID J75726034A

Me Vullnet të lire të plote , dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur :

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

Ne baze te Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqëritë tregëtare" dhe Ligji nr. 9723 date 03.05.2007 me ndryshimet " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit " krijojme shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, " EMPIRE TWO ON ONE" shpk TIRANE, Shqiperi.

NENI 1

Shoqeria tregtare, formohet nga Ortaku I sipercituar, me emrin " EMPIRE TWO ON ONE" shpk Tirane, emertimi i të cilit do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise " EMPIRE TWO ON ONE" shpk eshte :
Tirane,rruga "Frang Bardhi" ,zona kadastrale 8260,nr pasurie 6/313-N8

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim të Asamblese se ortakeve, mund të krijohen ose anulohen , seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njqintmije) leke , formuar dhe nenshkruar nga ortaket , vlere e cila do te shlyhet mbasi shoqeria te jete rregjistruar ne QKR dhe i perket ortakeve te mesiperm ne perpjesetimin e meposhtem :

Z. Viorel Neziri, zoterues i nje kuote me vlere 700 00 (shtatedhjete mije) lek,qe perben 70% te kapitalit themeltar

Z. Brixhilda Vokri, zoterues i nje kuote me vlere 30 000(tridhjete mije) lek,qe perben 30% te kapitalit themeltar

Shoqeria pergjigjet per humbjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 5



Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte mbi 10 vjet.
Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim QKR per të bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtar.

NENI 6

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7

Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil.



Ortakët, kanë të drejtë të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht kontributet e tyre përfshirë dhe fondet dhe kontributet e pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jenë të vertetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tillë Asambleja e Ortakëve duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqëria dhe të tjerët duhet të respektojnë këto transferime sapo t'u behen të ditura.

NENI 8

Objekti i veprimtarisë:

Veprimtari ekonomike në fushë të real estate & rikonstruksion, projektim, zbatim, mobilim.

Blerje dhe dhenie me qera të ndërtësive. Blerje, shitje, shkëmbim, valorizim, tregtim i tokave dhe të ndërtësive. Analizë dhe preventivë, ndërtim, ristrukturim, shkatërrim, rindërtim dhe recuperime ndërtimore të godinave, ndërtësive civile dhe industriale, rustike. Analizë dhe preventivë, realizim, administrim dhe mirëmbajtje e veprave të vogla dhe të mëdha infrastrukturore. Analizë dhe preventivë, realizim i çdo lloji veprave dhe punë ndërtimi.

Marrje punimesh për ndërtim, shitje, shkëmbim, ristrukturim, marrje dhe dhenie me qera, administrim dhe menaxhim pasurish të patundshme në përgjithësi, në pronësi si publike ashtu edhe private.

NENI 9

Me vendim të Asamblesës Ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtime të tjera të cilat janë me interes për mbarevajtjen e shoqërisë.

NENI 10

Me vendim të Asamblesës së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 11

Asambleja e Ortakëve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i njeh asamblesës së ortakëve.

Asambleja e Ortakeve mund t'ia delegoj kompetencat nje ose me shume administratoreve të caktuar prej saj ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e prokures.

NENI 12

Administrator I shoqerise "EMPIRE TWO ON ONE" shpk, eshte
2-Brixhilda Vokrri, datelindja 26/07/1997, lindur ne Rreshen dhe banues ne Tirane, madhor ,me zotesi te plote per te vepruar ,identifikuar me nr ID J75726034A

E cila eshte e zgjedhur ne kete pozicion per nje periudhe jo me shume se pese vjet .


NENI 13

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, te cilet nenshkruhen prej ortakut ne cdo faqe .

THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE

"EMPIRE TWO ON ONE" SHPK

VIORIEL NEZIRI



BRIXHILDA VOKRRI

